



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 627 Prot.
a

Tiranë më, 19.07.2019

Lënda: **Kthim përgjigje kërkesës së bashkisë Dropull për pajisje me Akt Përputhshmërie të draft Planit të Përgjithshëm Vendor Dropull**

BASHKISË DROPULL

Adresa: Dropull

Në përgjigje të shkresës Suaj me Nr. 1078 Prot, datë 18.06.2019, protokolluar pranë Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit me Nr. 627 Prot, datë 20.06.2019, me lëndë: "Kërkesë", Ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Në zbatim të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" e ndryshuar, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit ka kryer kontrollin e përputhshmërisë së dokumentave të "Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Dropull, botuar në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit (RKPT) më datë 06.06.2019 dhe plotësuar më datë 03.07.2019, sipas kërkesës së sipërcituar.

Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM Nr. 360, datë 29.05.2019 "Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijëve administrativë-territoriale të njësive të vetëqeverisjes vendore" me anë të së cilës janë përditësuar kufijtë administrativo-territoriale të njësive të vetëqeverisjes vendore. Pas mbivendosjes së kufirit të përdorur në draft PPV me kufirin e bashkisë Dropull të miratuar në VKM-në e sipërpërmendur vihet re që ka mospërputhje midis tyre. Për këtë arsye vlerësohet si e nevojshme përshtatja e kufirit të draft PPV me kufirin e përditësuar në VKM Nr. 360, datë 29.05.2019, duke përfshirë territoret të cilat aktualisht në draft PPV janë lënë jashtë territorit të bashkisë Dropull.

Gjithashtu vihet re që në material nuk janë reflektuar plotësisht kërkesat e kompanive të cilat operojnë në territorin e bashkisë Dropull.

Më konkretisht, kompania Alfa Sh.A me anë të shkresës me Nr. 146 Prot., datë 21.11.2018, protokolluar pranë AKPT me Nr. 1532 Prot., datë 27.11.2018 më lëndë "Kërkesë" ka paraqitur disa kërkesa për ndryshime në draft PPV Dropull. Këto ndryshime konsistojnë në ndryshimin e disa kushteve zhvillimore, në njësitë strukturore ku zhvillohet aktiviteti i kompanisë, për të akomoduar nevojat për zgjerim.

Në kushtet e mos reflektimit të plotë të kërkesës së sipër përmendur, kompania "ALFA" Sh.A ka dërguar në AKPT shkresën me Nr. 67 Prot., datë 17.06.2019, protokolluar në AKPT me Nr. 663 Prot., datë 26.06.2019, me lëndë "Kërkesë për korrigjim" në të cilën shprehin ankesën e tyre për mosplotësimin e plotë të kërkesave të tyre si dhe kërkohet ndryshim në njësinë strukturore DP_B_EB_112/1 të draft PPV Dropull. Kjo kërkesë i është përcjellë për vlerësim bashkisë Dropull dhe studios konsulente "Universitetit Polis më anë të shkresës me Nr. 663/1 Prot., datë 08.07.2019 më lëndë "Mbi kërkesën e kompanisë ALFA Sh.A për ndryshim në njësinë strukturore DP_B_B2_112/1", për të cilën në AKPT akoma nuk ka ardhur një qëndrim zyrtar nga ana e bashkisë.

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) si autoriteti përgjegjës për të bashkërenduar procesin e hartimit të dokumenteve të planifikimit të territorit, të cilat ndërmerren nga autoritetet e planifikimit në nivel qendror e vendor vlerëson si të nevojshme verifikimin e këtij rasti dhe reflektimin e tij në variantin final të dokumentit si dhe përshtatjen e kufirit të draft PPV Dropull me kufijtë e miratuar në VKM Nr. 360 datë, 29.05.2019.

Në mënyrë që të vijohet me procedurën e pajisjes së draft PPV Dropull me Akt Përputhshmërie, pas vlerësimit të rastit në fjalë si dhe pas përshtatjes së kufijëve është e nevojshme ribotimi i materialit në RKPT dhe ridërgimi në AKPT i kërkesës për Akt Përputhshmërie.

Bashkëlidhur kësaj shkresë lutem gjeni:

- Hartën ku janë mbivendosur kufijtë e përdorur në draft PPV Dropull me kufijtë e miratuar në VKM Nr. 360, datë 29.05.2019 "Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijëve administrativë-territoriale të njësisve të vetëqeverisjes vendore".
- CD me kufirin final të bashkisë Dropull në GIS.


Me respekt,

DREJTORE E PËRGJITHSHME



Adelina Greca

Konceptoi/ Punoi: E. Pashollari, M.Ferra
Pranoi/ Konfirmoi: F. Mali
Nr. Kopje: 2
Datë: 19.07.2019

Kufiri Administrativ, bashkia Dropull



Legjende

-  Kufijte e bashkise Dropull sipas VKM 360 date 29.05.2019
-  Kufiri i perdorur ne draft PPV Dropull



1:160,000